



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Uprava za Opštu Administraciju

Directory of General Administration

Nr. i prot. 3973 Më 05.12.25
Br. prot. DL
RAHOVEC - GRAHOVAC

Raporti i punës për periudhën janar - dhjetor 2025

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës së zyrtarit për Barazi Gjinore

- Mbledhja e parë si antarë i KKSBB-së për vitin 2025.
- Plotësim i pyetësorit kërkuar nga MAPL për pjesën e barazisë gjinore.
- Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Zyrën e UN Women Kosovë organizoi punëtorin me qëllim të mbështetjes në hartimin, rishikim dhe koordinim në zbatim të aktiviteteve të parapara në planet vjetore të punës për Zyrtarët/et për Barazi Gjinore (ZBGJ) në nivelin komunal.
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për përgatitjen e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave.
- Njoftim përmes e-mailit, i deklarimit të dhuratave për të gjithë drejtorët e drejtorive dhe punëtorët komunalë.
- Takim me kryetarin dhe grupin e performancës komunale, ku u diskutua për raportimin e të dhënave në sistem për vitin 2024.
- Pjesëmarrës në takimin e organizuar nga Organizata Medica Kosova në kuadër të projektit "Të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe të dhunës në familje kanë qasje të përmirësuar në shërbime sociale dhe mbrojtje institucionale" të financuar nga Ministria e Drejtësisë.
- U mbajt Punëtorja për zhvillimin e Planit të Veprimit në komunën e Rahovecit, aktivitet i organizuar nga Rrjeti Qeliza për anëtarët e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ku u diskutuan arritjet si dhe rekomandimet për punën e mëtejshme të këtij plani.
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën "Hartimi i dokumenteve strategjike Lokale" nga fusha Çështje Komunale.
- Marrja pjesë në tryezën e diskutimit organizuar nga Helvetas/DEMOS dhe Instituti GAP me temën "Avancimi i integritetit gjinor në komunat e Kosovës: Këndvështrim i politikave".

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

- **Aktivitete me rastin e 8 Marsit ditës ndërkombëtare të gruas:**
Pjesëmarrës në marshin paqësor organizuar nga shoqata "Hareja" së bashku me zyrën për Barazi Gjinore, me moton "Marshojmë s'festojmë", ku bëmë ecje nëpër qytet. Po ashtu, kemi organizuar një tryezë të rrumbullakët me gratë me temën "Krenare që jam grua", ku gratë në pozita udhëheqëse kanë rrëfyer për sfidat dhe të arriturat në jetën e tyre. (pjesëmarrëse ishin 25 gra dhe 2 burra).
- Plotësim i pyetësorit dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore/ZKM dhe UN Women Kosovë të cilët kanë realizuar një pyetsor si pjesë të analizës sektoriale të reformës në administratë publike. Ky pyetsor është në kuadër të projektit Instrumenti për Barazi Gjinore "Gender Equality Facility" (GEF) i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe i zbatuar nga UN Women.
- Pjesëmarrës në punëtorinë me temë "Mbrojtja e të dhënave personale në sistemin shëndetësor", kjo punëtori u organizua nga Agjencia për Informim dhe Privatësi mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë - OSBE.
- Marrja pjesë në trajnimin dy ditor 18-19 mars, organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën: "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë".
- Mbledhja e dytë e rregullt e KKSBB-së.
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) organizoi trajnimin "Çështjet gjinore dhe sfidat e ndërtimit të barazisë gjinore" nga fusha Çështje Komunale për zyrtarët profesional, trajnimi u mbajt me 25 dhe 26 mars.
- Plotësim i pyetësorit për Barazi Gjinore, me kërkesë të Administratës publike.
- Si punë shtes me vendim të kryetarit:
Njoftimi për deklaram të pasurisë përmes e-mailit për personat zyrtarë që kanë për të deklaruar pasurinë si deklarim i rregullt për vitin 2024.
- Pjesëmarrës në trajnimin dy ditorë organizuar nga projekti DEMOS për anëtarët e grupeve punues përgjegjëse për planifikimin, organizimin, lehtësimin dhe dokumentimin e dëgjimeve buxhetore, trajnimi ishte për qëllim të përmirësimit dhe avancimit të mëtutjeshëm të procesit të planifikimit buxhetor në nivel lokal 2 dhe 3 prill 2025.
- Mbledhja e parë e rregullt e mekanizmit koordinator komunal kundër dhunës në familje;
- Trajnim tre ditor organizuar nga Medica Kosova me temën: Hartimi i një Manuali mbi Qasjen e Ndjeshme ndaj Traumës dhe me Qendër Viktimën për Ofruesit e Shërbimeve, Përfaqësues të Institucioneve dhe OJQ-ve që Punojnë me Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore. Qëllimi i Trajnimit: Të pajisë ofruesit e shërbimeve dhe hartuesit e manualeve me njohuritë dhe mjetet për të krijuar një manual të ndjeshëm ndaj traumës, të përshtatur për nevojat e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore, duke siguruar ndjeshmëri, siguri dhe fuqizim në ofrimin e shërbimeve.
- Trajnim dy ditor 29-30 prill 2025 me ftesë nga Qendra e Trajnimit e Asociacionit të Komunave të Kosovës me temën: "Barazia Gjinore dhe Mjedisi" dhe "Fuqizimi i rolit të zyrtarëve për barazi gjinore në politikat mjedisore".

KOMUNA RAHOVEC

- Aktivitet në shkolla së bashku me zyrtarin nga zyra e institucionit të avokatit të popullit në Gjakovë Mark Kaqinari, dhe me koordinatoren për të drejtat e njeriut, ligjeratë me nxënësit e dy shkollave fillore "Sylejman Vokshi" në Polluzhë dhe shkolla fillore "31 Marsi" – Guri i Kuq, me temën: Të drejtat e fëmijëve;
- Pjesëmarrës në trajnimin tre-ditor me temën "Buxhetimi me Ndjeshmëri Gjinore në Nivel Lokal", që organizohet në kuadër të projektit "Monitorimi i Buxhetit me Ndjeshmëri Gjinore në Nivel Lokal", i financuar nga SELDI me mbështetje nga Bashkimi Evropian, dhe i implementuar nga Iniciativa e Femrës Kosovare;
- Takim me kryetarin e komunës dhe me anëtarët e Performancës komunale, qëllimi i takimit ishte Raportimi i të dhënave në performance për vitin 2024;
- Takim me grupin e dëgjimeve buxhetore, për kalendarin e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për KAB-in 2026-2028;
- Pjesëmarrës si anëtarë i grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026-2028, u mbajt dëgjimi publik në Sallën e Kuvendit me rininë, gratë, pensionistët dhe komunitetet pakicë;
- Dëgjimi publik në Sallën e Kuvendit me organizatat joqeveritare, bizneset, fermerë dhe grupet e interesit që veprojnë në komunën e Rahovecit;
- Dëgjimi publik në Sallën e Kuvendit me drejtorë të shkollave, koordinatore të cilësisë, psikologët dhe pedagogët, në komunën e Rahovecit;
- Dëgjimi publik në QKMF "Fahredin Hoti" me punëtorët shëndetësorë në komunën e Rahovecit;
- Plotësim i pyetësorit nga Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025-2035, rreth shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në komunën e Rahovecit;
- Dëgjimi publik në Sallën e Kuvendit me kryetarë të fshatrave dhe lagjeve urbane që veprojnë në komunën e Rahovecit;
- Dalje në teren si anëtar i komisionit për ankesa, së bashku me inspektoriatin dhe anëtarët tjetër të komisionit;
- Takim me kryetarin, drejtorët e drejtorive dhe grupin e performancës komunale, lidhur me raportimet në performancë 2024;
- Dalje në teren në fshatin Potaqan, si anëtar i komisionit për ankesa, së bashku me inspektoriatin, dhe anëtarët tjetër të komisionit;
- Pjesëmarrës në komision për shqyrtimin e dokumentacionit për mbështetjen financiare me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat;
- **Aktivitet i organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore**, mbështetur nga Agjencia për Barazi Gjinore – Trajnim për anëtarët e mekanizmit koordinues lokal për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, me temat: Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore dhe Konventa e Stambollit, përfshirja e Konventës së Stambollit në Kushtetutë dhe obligimet e shtetit në raport me këtë Konventë.
- Përgaditja e Analizës Gjinore - Buxhetimi Gjinor, për Kornizën Afatmesme Buxhetore KAB-2026-2028;

KOMUNA RAHOVEC

- Pjesëmarrja në dëgjimin publik buxhetor për buxhetimin gjinor, me vajzat dhe gratë e komunës së Rahovecit për KAB-2026-2028;
- Pjesëmarrës në trajnim "Avancimi i integritetit gjinor në komunat e Kosovës përmes ngritjes së cilësisë së raportimit në Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Komuna" organizuar nga Helvetas/projekti DEMOS, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia;
- Punëtorja e organizuar nga OSBE në ngjarjen e Seksionit për Ligj dhe Drejtësi lidhur me: Implementimi i Rregullores për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore;
- Mbledhja e tretë e KKSBB-së, në sallën e konferencës në kompleksin muzeor- Ukshin Hoti në Krushë të Madhe;
- Plotësimi i Raportit për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane Janar-Qershor 2025 - pjesa e barazisë gjinore;
- Takim në zyre me drejtoreshën e shoqatës "Fuqizimi i gruas dhe rinisë" Suharekë, qëllimi i takimit ishte mbajtja e trajnimit katër ditore, Korrik-Gusht, me temat bizneset start-up dhe marketingu, u dakordua edhe me drejtorin e kulturës që trajnimet të mbahen në shtëpinë e kulturës "Mensur Zyberaj";
- Përgaditja e Raportit gjashtë mujor për Mekanizmin koordinues komunal kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.
- Dëgjimi i parë buxhetor në Krushë të Madhe me gratë në biznes ku u mbajt në kafiterinë "Ana Caffè".
- Dëgjimi i dytë buxhetor në Krushë të Madhe me gratë në biznes ku u mbajt në Kooperativën bujqësore "Krusha".
- Pjesëmarrës në trajnimin dy ditor me temën "Plan biznesi" në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave dhe të rinjve përmes trajnimeve në ndërmarrësi në komunat Rahovec dhe Suharekë.
- Pjesëmarrës në dëgjimin buxhetor me gra dhe vajza për të mbledhur kërkesat dhe nevojat mbi buxhetin e vitit 2026.
- Tryezë diskutimi e cila po realizohet në përmbysje të projektit "Organizatat e grave dhe institucionet ofrojnë mbrojtje sociale dhe drejtësi me qasjen e bazuar në nevojat e viktimave dhe qasje të ndjeshme ndaj traumës, organizuar nga Medica Kosova.
- Pjesëmarrës me ftese për takim pune - shkëmbim përvojash rreth planifikimit të buxhetit, organizuar nga Demos.
- Pjesëmarrës si anëtar i grupit në takimin e parë të buxhetimit me pjesëmarrje, i cili takim u mbajt në parkun e qytetit.
- Takim në zyre me zyrtarin nga Caritas Kosova Jetmir Bakija, ku u diskutua lidhur me punësimin e grave nëpër institucionet publike dhe private, subvencionimet nga komuna, bashkëpunimet me Organizatat e huaja dhe vendore si dhe numrin e pronave në emër të dy bashkëshortëve.
- Pjesëmarrës në ciklin e takimeve për buxhetim me pjesëmarrje, ku banorët e shumtë votuan për projektin "Hapja e lumit në fshatin Opterushë.


KOMUNA RAHOVEC

- Pjesëmarrës si panelist me ftesë të organizatës YMCA, e cila në bashkëpunim me ATRC dhe me mbështetje nga Banka Botërore është duke implementuar projektin "Bëje Tënden" që synon edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve dhe të rejave rreth së drejtës së barabartë në trashëgimi dhe pronë, në SHML "Xhelal Hajda- Toni" në Rahovec, me temën: "Question Time: Të Rinjtë dhe të Drejtat Pronësore".
- Mbledhja e 4 (katërt)- të e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025, mbledhja u mbajt në sallën e Qendrës Kulturore "Jah Hoti" – Ratkoc.
- Në sallën e Kuvendit Komunal, në prani të përfaqësuesve të institucioneve publike lokale, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, mbajti takim informues mbi të drejtat e të mbijetuarve të torturës dhe dhunës seksuale, si dhe ndalimin e stigmës si një damkë shoqërore që i ka përcjellur të mbijetuarit për gjithë këto vite. Të pranishëm ishin tre të mbijetuarit e dhunës seksuale.
- Pjesëmarrës në punëtorinë organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), i mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, me temën: Forcimi i Rolit të ZKBGJ-ve dhe ZKI-ve në adresimin e dhunës ndaj grave në politikë.
- Takim me Agjencionin për Barazi Gjinore, qëllimi i takimit ishte: Organizmi i nevojave për trajnime; Planifikimi i aktiviteteve në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit"; Të gjitha aktivitetet tjera të përbashkëta deri në fund të vitit.
- Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, organizoi "Punëtori mes komuniteteve fetare dhe Policisë së Kosovës mbi parandalimin e incidenteve të sigurisë", Punëtorja ka për qëllim të ofrojë një platformë për diskutim mbi rolin dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të këshillit komunal për sigurinë në bashkësi, përfshirë përfaqësues të komuniteteve fetare dhe Policisë së Kosovës, në parandalimin e incidenteve të sigurisë.
- Mbledhja e 5 (pest)- të e rregullt e KKS-së.
- Pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët organizuar nga shoqata e gruas "Hareja", me rastin e ditës botërore të personave të moshuar, ku u prezantua projekti "Fuqizimi i grave të moshuara, promovimi i shëndetit, tejkalimi i vetmisë".
- Plotësim i një ankete në kuadër të projektit "Parandalimi i dhunës me bazë gjinore përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes", të implementuar nga QKSGJ në bashkëpunim me Solidar Suisse dhe të financuar nga Komisioni Evropian.
- Takim me drejtoreshën e gjimnazit "Xhelal Hajda-Toni", qëllimi i takimit ishte mbajtja e një trajnimit me nxënësit e shkollës në muajin Nëntor, së bashku me organizatën SIT.
- Dalje në teren si anëtar i komisionit për shqyrtimin e ankesave në inspektoriat.
- Aktivitet i organizuar me kërkesë të Zyres për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me organizatën SIT dhe Friedrich Ebert Stiftung, me nxënësit e Gjimnazit "Xhelal Hajda-Toni", Rahovec me temën "Maskuliniteti", trajnimi u mbajt në shkollë ku pjesëmarrës ishin 28 nxënës të gjinisë mashkullore.

KOMUNA RAHOVEC

- Marrja pjesë në tryezën e rrumbullakët organizuar nga Medica Gjakova me temë: "Roli i mekanizmave komunalë në barazinë gjinore dhe mbështetjen e të mbijetuarave", synimi i takimit ishte të forcojë bashkëpunimin ndërmjet mekanizmave komunalë për barazi gjinore dhe organizatave të shoqërisë civile, duke nxitur zhvillimin e qasjeve të ndjeshme ndaj traumës dhe destigmatizimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale gjatë luftës.
- Misioni i OSBE-së në Kosovë organizojë një tryezë të rrumbullakët për të diskutuar praktikat aktuale të subvencionimit, sfidat si dhe të ndajnë praktikat e mira të subvencionimit. Qëllimi i takimit ishte të diskutohen praktikat aktuale të subvencionimit në komuna, ndikimi i tyre, fushat e mundshme për përmirësim, për të njoftuar strukturat e reja komunale në vitin e ardhshëm.
- Takim me kryetarin dhe me grupin e performancës komunale.
- Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Agjencia për Barazinë Gjinore organizoi një trajnimin për Ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin kundër diskriminimit në baza gjinore, në kuadër të fushatës "16 ditë aktivizëm kundër dhunës në familje"
- Pjesëmarrës në takimin përmbyllës me projektin "Gratë dhe vajzat në fokus të jetës kulturore në zonat rurale të rajonit të Prizrenit" nga OJQ YES, ku u bë prezantimi i arritjeve nga terreni dhe rekomandimet për vazhdimësinë.
- Marrja pjesë në punëtorinë nga Zyra komunale për Informim, me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), me temën: Prezantimi i Udhëzuesit për qasje në dokumente publike dhe mbrojtje të të dhënave personale.
- Punë shtesë me vendim të kryetarit: Zyrtar kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrillin e pasurisë. Regjistrimi për deklarim të rregullt dhe deklarim përfundimtar të pasurisë për personat zyrtar sipas Ligjit NR. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave.

Alban Gashi



Zyrtar për Barazi Gjinore
Komuna Rahovec

5.12.2025

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme